

Dt. 13.02.2025

STATUTI

I

SHOQERISE "IMPERIAL IH" SHPK

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Me anë të këtij Statuti, të hartuar ne 3 (tre) kopje origjinale:

Ortaku themelues Znj. Brikena Hoxha, e bija e Hasan-it, lindur në Elbasan, me datën 02.01.1966, banuese në Elbasan në adresën: Rruga "Bedri Xhomo", Ndërtesa nr.11, Hyrja.2 , Apartamenti nr.9 . Kodi Postar 3001, mbajtese e letërnjoftimit me nr. Personal G65102003N, madhore dhe me zotesi të plotë juridike e për të vepruar;

Ortaku themelues Z. Brian Hoxha, i biri i Ilirit-it, lindur në Elbasan, me datën 13.07.1988, banues në Tiranë në adresën: Rruga "e Dafinave", Ndërtesa nr.2, Hyrja nr.1, Apartamenti nr.14, Njesia Administrative nr.7 , Kodi Postar 1023, mbajtes i letërnjoftimit me nr. Personal I80713077A, madhor dhe me zotesi të plotë juridike e për të vepruar

deklarojnë se:

Neni 1

THEMELIMI

Kemi themeluar shoqërinë me përgjegjesi të kufizuar me emrin "**IMPERIAL IH**" shpk, e cila është organizuar dhe do të funksionojë në perputhje me kërkesat e këtij Statuti dhe legjislacionit Shqiptar në fuqi. Shoqëria do të fitojë personalitet juridik, pas regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë është në adresën: Lagjja "Dyli Haxhire", Rruga Kadri Hoxha, Ura Zaranika, Hotel Imperial, , Kodi Postar 3001, Elbasan.

Asambleja e Përgjigjithshme, nëse e quan të nevojshme dhe në interes të shoqërisë, mund të hapë filiale dhe degë të tjera në Shqipëri ose jashtë saj, dhe t'i mbyll ato, kur e konsideron se shkaqet e hapjes se tyre nuk ekzistojnë më.

Neni 3

KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT

Aktiviteti i shoqërisë do të ushtrohet për një periudhë të pakufizuar kohore.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Hoteleri turizëm, import-eksport të mallrave ushqimore, industriale, makineri e pajisje të ndryshme, transport udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit, agjenci turistike incoming, bar-restorant, pishinë, sauna, trajtime estetike, mirëmbajta, shërbime trajnimi dhe konsulence.

Te kryeje çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për të realizuar objektin e veprimtarisë së Shoqërisë.

Shoqëria mund të ushtrojë çdo veprimtari tjetër tregtare dhe prodhuese, e cila nuk ndalohet me ligj. (Neni 7 i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2018 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”)

Neni 5

Për përmbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marr pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjte ose të përafërt me të sajën dhe mund të kryeje direkt apo indirekt të gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter të luajtshëm e të paluajtshëm.

Shoqëria mund të hapë dhe të mbaj llogari rrjedhëse në lekë apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke mundur gjithashtu të disponojë lirisht mjetet monetare të akumuluar në llogaritë e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Aktiviteti tregtar i shoqërisë “**IMPERIAL IH**” shpk, në vazhdimësi do të organizohet dhe funksionojë mbi bazën e diapozitave të këtij Statuti, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar.

KREU II KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA

Neni 7

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kontributë në natyrë dhe kontribute në para.

Kontributi në natyrë, sipas raporteve të vlerësimit përbëhet nga pasuria nr. 391/3 regjistruar në Volum 46, Faqe 224, Zona Kadastrale 8523, e llojit “Truall”, me sipërfaqe 5000 m², pasuria nr. 391/2-ND, regjistruar në Volum 46, Faqe 120, Zona Kadastrale 8523, e llojit “Ndërtesë”, me sipërfaqe 182 m², pasuria e cila është shtesë e pasurisë nr. 391/2-ND, e cila është në proces legalizimi pranë ASHK-Elbasan si dhe nga pasuria nr. 1/85, regjistruar në Volum 14, Faqe 224, Zona Kadastrale 8521, e llojit “Truall”, me sipërfaqe 589 m² Truall dhe 287.8 m² Ndërtesë.

Bazuar në Raport Vlerësimi, datë 23.12.2024 për pasurinë nr. 391/3 dhe pasurinë nr. 391/2-ND, kontributi në natyrë është në vlerën 149 360 000 lekë, ndërsa vlera e pasurive të paregjistruara por në proces legalizimi, shtesë të pasurisë nr. 391/2-ND është 688 250 000 lekë. Pra, kontributi në natyrë është në vlerën totale 837 610 000 lekë.

Bazuar në Raport Vlerësimi, datë 23.12.2024 për pasurinë nr. 1/85, kontributi në natyrë është në vlerën 200 380 000 lekë.

Kontributi në natyrë, në total, është në vlerën 1 037 990 000 lekë.

Kontributi në para do të jetë në vlerën 8 000 000 lekë.

Kapitali i shoqërisë është nënshkruar plotësisht dhe zotërohet nga ortakët i shoqërisë, znj. Brikena Hoxha, 75 % me 1 (një) kuotë, dhe nga z. Brian Hoxha me 25 % me 1 (një) kuotë.

Vlera e kontributit në natyrë, e cila zotërohet nga ortakët i shoqërisë, znj. Brikena Hoxha, në masën 75 % të kontributit në natyrë, totalit të 1 037 990 000 lekë, është në vlerën 778 492 500 lekë.

Vlera e kontributit në natyrë, e cila zotërohet nga ortakët i shoqërisë, z. Brian Hoxha, në masën 25 % të kontributit në natyrë, totalit të 1 037 990 000 lekë, është në vlerën 259 497 500 lekë.

Vlera e kontributit në para, e cila zotërohet nga ortakët i shoqërisë, znj. Brikena Hoxha, në masën 75 % të kontributit në para, totalit 8 000 000 lekë, është në vlerën 6 000 000 lekë.

Vlera e kontributit në para, e cila zotërohet nga ortakët i shoqërisë, z. Brian Hoxha, në masën 25 % të kontributit në para, totalit 8 000 000 lekë, është në vlerën 2 000 000 lekë.

Për vërtetimin e pronësisë mbi kuotat e mësipërme shoqëria tregtare mund të lëshojë në emër të personit, që zotëron kuotën, një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit.

KREU III

TRANSFERIMI (KALIMI) I KUOTËS SË KAPITALIT THEMELTAR

Neni 8

Kuota e kapitalit themeltar është lirisht e transferueshme tek të tretët. Transferimi (kalimi) i kuotës mund të bëhet me kontratë shitblerje, me kontratë dhurimi, me trashëgimi, dhe në çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

KREU IV



Neni 9

ASAMBLEJA

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë. Në shoqërinë "IMPERIAL IH" shpk, atributet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakët znj. Brikena Hoxha dhe z. Brian Hoxha.

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e saj dhe janë të detyrueshme për të gjitha organet e shoqërisë. Vendimet e asamblesë protokollohen në një regjistër të veçantë në përputhje me ligjin.

Asambleja ka të drejtë të ushtrojë në çdo moment verifikime mbi Administratorin/ët dhe të kontrollojë çdo dokument të shoqërisë. Ajo mund të urdhërojë apo të udhëzojë administratorin/et në kryerjen e detyrës së tij/tyre.



Asambleja ka keto kompetenca:

- Vendors për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive të zhvillimit, përfshirë edhe investimet kapitale;
- Vendors për ndryshimet e statutit;
- Emëron dhe shkarkon Administratorin/et, likuiduesit dhe audituesit ligjorë, si dhe përcakton shpërblimet e tyre;
- Mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori/ët, miraton buxhetin vjetor të shoqërisë dhe raportet e ecures së veprimtarisë;
- Vendors për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Vendors për pjesëtimin e kuotave dhe/ose anulimin e tyre;
- Vendors për riorganizimin (shëndrrimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë);
- Vendors prishjen e shoqërisë dhe kalimin e saj në likuidim;
- Vendors për transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkëmbimin) e pasurive të shoqërisë, për cedimin apo për dhënien me qira të shoqërisë ose degeve të saj, për dhënien me qira të aseteve të shoqërisë, për marrjen me qira të objekteve apo aseteve të ndryshme, për kontratat leasing, për pjesëmarrjen në kapitalin e kompanive të tjera nepermjet pjesëmarrjes në kapital, blerjes së kuotave apo aksioneve;
- Vendors për miratimin e huamarrjeve me interes nga të tretet, si dhe për huamarrjet pa interes;
- Vendors për dhënien e garancive hipotekore, pengut, barrëve siguruese, dorëzatisë etj;
- Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e audituesve ligjorë;
- Miraton shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve, vendors për ndarjen e dividendit ose për kapitalizimin e tyre nëpërmjet zmadhimit të kapitalit;
- Miraton strukturën organizative të shoqërisë, rregulloren e brendshme dhe organigramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikat dhe nivelin e pagave dhe shpërblimeve për çdo vend pune në shoqëri;
- Vendors për çështje të tjera të parashikuara nga ligji;

Neni 10

MËNYRA E THIRRJES, PËRFAQESIMI DHE VENDIMARRJA E ASAMBLESË.

Asambleja e përgjithshme thirret në mënyrën e përcaktuar në nenin 83 e vijues të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

Përfaqësimi i ortakut/eve në asamble bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 83 e vijues të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

Vendimet e Asamblesë që merren me shumicë të zakonshme, janë të gjitha vendimet e Asamblesë për të cilat Ligji dhe Statuti nuk kërkojnë një shumicë të cilësuar.

Vendimet që merren me shumicë të zakonshme janë të vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm ortakët (me të drejtë vote) që zotërojnë më shumë se 30 % të kapitalit të shoqërisë (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marrë nëse është vendosur me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. Në rast se nuk arrihet Kuorumi i përcaktuar, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Për Vendimet e Asamblesë që merren me shumicë të cilësuar, mbledhja është e vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm ortakët (me të drejtë vote) që zotërojnë më shumë se 3/4 të kapitalit të shoqërisë (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marrë nëse është vendosur nga ortakët që zotërojnë

më shumë se 3/4 të numrit total të votave të ortakeve pjesëmarres. Në rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar me sipër, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Merren me shumice te cilesuar keto vendime:

- Ndryshimi i Statutit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- Riorganizimi (shëndërrimi, bashkimi, ndarja) ;
- Prishja e shoqërisë dhe kalimi i saj në likuidim;
- Zgjidhja e administratorit

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakeve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Nëse Asambleja e Përgjithshme, refuzon kërkesën e ortakeve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, për nisjen e një hetimi të posaçëm ose nuk jep përgjigje brenda 60 ditëve atëherë, kërkesit kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës.

Neni 11

ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Zmadhimi i kapitalit themeltar vendoset nga Asambleja me vendimarrjen e ortakëve që zotërojnë më shumë se 3/4 të numrit total të votave të ortakeve pjesëmarres. Pas vendimit të Asamblesës Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit, ortakët brenda 30 ditëve duhet të bëjnë derdhjet respektive, në proporcion me kuotën e kapitalit që zotëron secili.

Ortaku që ka votuar kundër zmadhimit të kapitalit nuk është i detyruar të kontribuojë.

Depozitimi i kapitalit të zmadhuar, bëhet vetëm nga ortaku/ët që kanë votuar pro rritjes së kapitalit, secili sipas kuotës që është vendosur në asamble. Në mungesë të marrëveshjes për rindarjen e kuotave, barazohet me 100 (njëqind) shuma e kapitalit pas zmadhimit. Pas derdhjes së kontributeve të sipërpërmendura, Administratori/et duhet të regjistrojnë në librin e ortakut zmadhimin e kapitalit, duke marrë dhe nëshkrimin e tij.

Administratori/ët në bazë të ligjit dhe pa autorizim paraprak të Asamblesës, mund t'u kërkojnë informacione ortakut kur ai ka nënshkruar zmadhimin e kapitalit, në lidhje me derdhjen e kontributeve brenda afatit të sipërpërmendur.

Neni 12

ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja me vendimarrjen e ortakëve që zotërojnë më shumë se 3/4 të numrit total të votave të ortakeve pjesëmarres.

Kur vendimi i zvogëlimin të kapitalit nuk motivohet nga humbjet në aktive, kreditorët e shoqërisë duhen njoftuar menjëherë. Kreditorët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin pranë organeve gjyqësore.

Neni 13 SHNDERRIMI

Shnderrimi i shoqërisë në shoqëri aksionare, behet mbas hartimit të raportit përkatës nga Administratori dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme me një shumicë prej tre të katërtave, në përputhje me nenet 228 dhe 229 të Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare". Është i pavlefshëm çdo transformim i shoqërisë në kundërshtim me këtë dispozite.

Neni 14 ADMINISTRIMI

Administrimi i shoqërisë i besohet Administratorit, **Z. Brian Hoxha**, i biri i Ilir-it, lindur në Elbasan më datë 13.07.1988, banues në adresën: Rruga "e Dafinave", Ndërtesa nr.2, Hyrja nr.1, Apartamenti nr.14, Njesia Administrative nr.7, Kodi Postar 1023, Tiranë, mbajtes i letërnjoftimit me nr. personal I80713077A.

Administratori emërohet për një periudhë prej 5 vjetesh me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim dorëheqje apo shkarkimi nga ana e Asamblesë.

Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Në përmbushje të detyrës së tij, ai ka të drejtën dhe detyrimin që të kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe konkretisht:

- Të zbatojë politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- Të përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për "Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut si edhe mund të vërë në lëvizje organe administrative dhe gjyqësore, duke autorizuar avokatë dhe lëshuar autorizime në raste mosmarreveshesh gjyqësore, duke kryer operacione bankare, përfshirë këtu edhe hapjen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me lekë në dore apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Viti financiar fillon më 01 Janar deri më 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 15

Administratori mund të emërojë përfaqësues, të cilëve, individualisht apo kolektivisht, mund t'u japë të drejtën e firmës, duke i përcaktuar kompetencat dhe garancitë që do të vlerësojë të arsyeshme. Ai mundet gjithashtu të emërojë drejtues ose përfaqësues për akte apo kategori aktesh të caktuara. Lidhur me shpërblimin e përfaqësueve të emëruar nga administratori, do të vendosë asambleja e ortakëve.

Neni 16

PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori (apo administratoret nëse do të emërohen të tillë) janë përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkeljet ligjore të Statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj të tretëve, për aktivitete dhe transaksione të kryera nga administratori në kapërcim të kompetencave të tij, kur vërteton se ata ishin në dijeni të kësaj rrethane.

Administratori përgjigjet personalisht para shoqërisë dhe/ose të tretëve që kanë pësuar dëme nga ndonjë veprim i tij i paligjshëm.

Neni 17

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke e shoqëruar me motivacionin përkatës. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorëve, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administratori/rët mund të heqi/in dorë në çdo kohë nga detyra e tij/tyre, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/rët, që paraqet dorëheqjen, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja e tij të ketë hyrë në fuqi.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen "Qendrës Kombëtare të Biznesit", së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

Neni 18

AUDITUESIT LIGJORE

Emërimi i audituesve ligjorë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përcakton mandatin dhe shpërblimin.

Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencën e audituesit ligjor, janë të pavlefshme veprimet/operacionet e kryera pa prezencën e tij.

Neni 19

Audituesi ligjorë pasi ka verifikuar librat kontabël, arkën dhe depozitat bankare, garanton që kontabiliteti vjetor është mbajtur në rregull, i korrespondon të vërtetës dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Audituesi ligjorë mund të shkarkohet nga funksionet e tij me vendim të Asamblesë së Përgjithshme si dhe me vendim gjykatë.

Audituesi ligjorë përpilon dhe i paraqet Asamblesë një raport financiar mbi ushtrimin vjetor që pasqyron situatën financiare në nisje dhe atë në mbyllje.

Ai kontrollon që bilanci përfundimtar dhe Raporti i përpiluar nga Administratori për Asamblenë, t'i korrespondojë realitetit.

Audituesi ligjorë është i detyruar t'i paraqesë Administratorit dhe Asamblesë së ortakeve:

- a) Kontrollat, verifikimet dhe sondazhet e bëra;
- b) Zërat e bilancit dhe dokumentacionin kontabël që duhet korrigjuar duke sugjeruar edhe zgjidhjet;
- c) Gabimet dhe pasaktësitë e konstatuara;
- d) Rezultatit financiar pas korrigjimeve të bëra;

Ai duhet të thirret në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së ortakeve ku aprovohet bilanci i aktivitetit vjetor, por mund të thirret edhe në të gjitha rastet kur konsiderohet e nevojshme.

Neni 20

Audituesi ligjorë përgjigjet ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e negative që rrjedhin nga gabime e neglizhime në kryerjen e funksionit të tij.

Nuk mban përgjegjësi për shkeljet ligjore të kryera nga administratori, me përjashtim të rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk ia ka paraqitur dhe raportuar para asamblesë.

KREU IV FITIMI DHE FONDET RREZERVE

Neni 21

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar të sapa mbyllur. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për formimin dhe shpërndarjen e fondeve të ndryshme.

Neni 22

Asambleja e Përgjithshme vetëm pasi ka miratuar bilancin përfundimtar dhe ka vendosur shumën që do të shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për ortakët e saj.

Shoqëria mund t'i shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse administratori apo administratorët, nën përgjegjësinë e tyre personale, lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nenit 77 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Gjate vitit, shoqëria ka të drejtë t'i japë ortakëve paradhënie mbi dividendët në vlera jo më të mëdha se dividendi i shpërndarë një vit më parë, me kusht që:

- a) Të mbetet e depozituar një rezervë, e barabartë me paradhëniet që do të shpërndahen;
- b) Një audituesi ligjorë të vërtetojë në një relacion me shkrim që fitimet neto të realizuara deri në atë moment janë me të mëdha se paradhëniet që parashikohen për t'u shpërndarë ortakeve.

Shpërndarja e paradhënieve vendoset nga Asambleja. Në vendimin përkatës duhet të specifikohen shumat dhe datat e kthimit. Dividendët që nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakeve që i kanë marrë ato.

KREU V

PAVLEFSHMERIA E SHOQERISE, PRISHJA, LIKUJDIMI DHE LARGIMI I ORTAKEVE

Neni 23

Pavlefshmeria e themelimit të shoqërise, mund të konstatohen apo të shpallen vetëm nëse plotësohen një apo disa nga kushtet e parashikuara në nenin 3/1 të Ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar. Pasojat e pavlefshmerisë, do të zgjidhen në përputhje me kërkesat e dispozitës së sipërcituar.

Neni 24

Shoqëria mund të priset vetëm në keto raste:

- a) Për çdo shkak të vendosur nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;
- b) Me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) Kur mbaron afati i veprimtarisë së përcaktuar në Statut dhe asambleja nuk merr vendim për zgjatjen e afatit të veprimtarisë;
- d) Në rast se bëhet i përealizueshëm objekti i veprimtarisë së shoqërisë, për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve drejtuese të shoqërisë (asamblese së përgjithshme) apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- dh) Në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara ligj;
- e) Në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

Neni 25

LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë pasi të njoftojë me shkrim për arsyet e largimit shoqërinë.

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Në rastet e largimit, përjashtimi dhe zgjidhjes së pasojave për keto raste zbatohen


parashikimet e neneve 102, 103 dhe 104 te Ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 26
LIKUIDIMI

Kur me vendim gjykatë shpallet pavlefshmëria e shoqërisë, si dhe në rastet e parashikuara në statut, asambleja e përgjithshme vendos prishjen e parakohshme të shoqërisë dhe fillojnë procedurat e likuidimit që do të kryhen sipas kërkesave të parashikuara në ligjin "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar dhe nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

ORTAKËT E SHOQERISE "IMPERIAL IH" SHPK

Brian Hoxha



(_____)

Brigene Hoxha

